FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.125 2 shtator 2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7074 datë 1.8.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	5433
Dekret nr.7075 datë 1.8.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	5433
Dekret nr.7077 datë 4.8.2011	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare	5434
Dekret nr.7080 datë 9.8.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	5435
Vendim i KM nr.515, datë 6.7.2011	Për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes në ngastrat e ekonomisë pyjore "Zalli Shkumbin", Elbasan, që do të përdoret nga shoqëria koncesionare "WET-t" sh.p.k., për ndërtimin e hec-it Topçias	5435
Vendim i KM nr.537, datë 27.7.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve "Lashkizë 1" dhe "Lashkizë 2" dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë	5438
Vendim i KM nr.538, datë 27.7.2011	Për miratimin e disa ndryshimeve në autorizimin dhënë "Enpower Albania" sh.p.k. për ndërtimin e centralit elektrik me erë (parqe eolike) të miratuar me vendimin nr.512, datë 13.5.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar	5438
Vendim i KM nr.539, datë 27.7.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.112, datë 21.2.2007 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë", të ndryshuar	5441

Vendim i KM nr.540, datë 27.7.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.489, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave "Për fondin e garantimit të kredive të eksportit"	5441
Vendim i KM nr.542, datë 27.7.2011	Për disa ndryshime në vendimn nr.31, datë 20.1.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e lejes për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare, të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar, ndërmjet Kallmet/Lezhë (Shqipëri) dhe Zapponeta/Manfredonia	5442
Udhëzim i MASH nr.30, datë 4.8.2011	Për një ndryshim në "Dispozitat normative të arsimit parauniversitar"	5442
Udhëzim i MASH nr.33, datë 5.8.2011	Për procedurën e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të parë dhe të dytë të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë privat si edhe për transferimin e studimeve për vitin akademik 2011-2012	5443
Urdhër i MB nr.319, datë 4.8.2011	Për delegimin e autoritetit, për miratimin e pagesave të shtesës për orë pune mbi kohën normale të punës, për punonjësit e Policisë së Shtetit	5445
Urdhër i MB nr.322, datë 9.8.2011	Për delegim kompetence	5445
Vendim i ERE nr.63, datë 27.7.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Erma Mp" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike..	5446
Vendim i ERE nr.64, datë 27.7.2011	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë "Erma Mp" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike ..	5447
Vendim i ERE nr.65, datë 27.7.2011	Për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë "Favina 1" sh.p.k. me seri pv05p, nr.29, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.85, datë 27.12.2005	5448
Vendim i ERE nr.66, datë 27.7.2011	Për licencimin e shoqërisë "Idro Energjia Pulita" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	5449
Vendim i ERE nr.67, datë 27.7.2011	Për licencimin e shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	5450
Vendim i ERE nr.68, datë 9.8.2011	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë "Hp Ostrovica Energy" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues (hec Faqekuq 1 dhe hec Faqekuq 2) si burim i rinovueshëm energjie	5451
Vendim i ERE nr.69, datë 9.8.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Diteko" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et në lumin "Zalli i Okshtunit": "Borovë", "Zabzun", "Sebisht", "Prodan 1", "Prodan 2", "Okshtun ekologjik", "Ternovë", "Okshtun", "Lubalesh 1", "Lubalesh 2" dhe "Gjoricë"	5452

Vendim i ERE nr.70, datë 9.8.2011	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Diteko” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	5453
Vendim i ERE nr.71, datë 9.8.2011	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Diteko” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec-et në lumin Zalli i Okshtunit”: hec-et “Borovë”, “Zabzun”, “Sebisht”, “Prodan 1”, “Prodan 2”, “Okshtun ekologjik”, “Ternovë”, “Okshtun”, “Lubalesh 1”, “Lubalesh 2” dhe “Gjoricë” si burim i rinovueshëm energjie	5454
Vendim i ERE nr.72, datë 9.8.2011	Për miratimin e transferimit të asetit, përkatësisht nënstacionin 110/20kv të “Kalimashit” nga OST sh.a. tek shoqëria “Cez Shpërndarje” sh.a.	5455
Vendim i KKRT nr.208, datë 25.7.2011	Për dhënie licence për radion private vendore “City Radio Albania”	5455
Vendim i KKRT nr.209, datë 25.7.2011	Për dhënie licence për radion private vendore “Radio Clazz” sh.p.k.....	5456
Vendim i KKRT nr.212, datë 25.7.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Elrodi”.....	5457
Vendim i KKRT nr.213, datë 25.7.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Blu Sky”	5457
Vendim i KKRT nr.214, datë 25.7.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik me përsëritës “RFI”	5458
Vendim i KKRT nr.215, datë 25.7.2011	Për mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Dardan”.....	5458
Vendim i KKRT nr.222, datë 25.7.2011	Për zgjerim zone licencimi për radion private vendore “Albania fm”	5460
Vendim i KKRT nr.223, datë 1.8.2011	Për vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Durrësi”.....	5461

DEKRET
Nr.7074, datë 1.8.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të nenit 9, pika 7, nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Minire Xhemajl Curri
2. Ramize Xhemajl Curri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.7075, datë 1.8.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të neneve 19 dhe 24 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Viron Koço Cinxo
2. Ajrije Ajdin Cinxo
3. Agron Ismail Ymeri
4. Etemije Servet Ymeri
5. Madona Agron Ymeri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.7077, datë 4.8.2011

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Flavja Besnik Jaçe
2. Blerta Kujtim Jusaj (Plaku)
3. Arta Pëllumb Ante (Burimi)
4. Gentiana Ndue Ndoja (Tushi)
5. Besiana Qamil Manaj (Metaj)
6. Lirim Ismet Torba
7. Luiza Mufit Torba (Kupa)
8. Endri Lirim Torba
9. Klaudia Lirim Torba
10. Bajram Lirim Torba
11. Tushe Ahmet Grau (Lika)
12. Danjela Jorgji Rege (Kamani)
13. Nisida Agron Gjoksi
14. Redon Arben Gashi
15. Fodioni Kristo Miçaço
16. Greta Ibrahim Shehi
17. Albert Sulejman Shima
18. Alban Gjelosh Mernaçaj
19. Vjollca Zef Boßhammer (Bushi)
20. Alida Kol Ndoci (Nikaj)
21. Aurora Kalo Diessner (Sinani)
22. Gezim Qamil Kajmeni
23. Eno Ernesto Suma

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr.7080, datë 9.8.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të nenit 9, pika 7, nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të saj:
Eliza Patricia Dushku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.515, datë 6.7.2011

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E EKONOMISË PYJORE "ZALLI SHKUMBIN", ELBASAN, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA KONCESIONARE "WET-T" SHPK, PËR NDËRTIMIN E HEC-IT TOPÇIAS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja në ngastrat 22/a, 22/b dhe 22/c, të ekonomisë pyjore "Zalli Shkumbin", në teritorrin e komunës Shirgjan, Elbasan, gjithsej 8.7 (tetë pikë shtatë) ha, që do të përdoret nga shoqëria koncesionare "W.E.T-T" sh.p.k., për ndërtimin e nyjes hidroenergjetike, Topçias, të hiqet nga fondi pyjor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të fondit pyjor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqes së këtyre ngastrave sipas pikës 1 të këtij vendimi, bën çrregjistrimin e saj nga kategoria "Tokë e zënë, tokë me bimësi pyjore" dhe e regjistron në sipërfaqe truall për ndërtimin e HEC-it Topçias sipas kondicioneve të sheshit të ndërtimit, të parashtruara në aneksin 1 dhe planimetrinë bashkëlidhur, në përputhje me vendimin nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor".

3. “W.E.T-T” sh.p.k., të paguajë për sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor, si pasojë e ushtrimit të veprimtarive të parashikuara, tarifat e llogaritura sipas lidhjes 4 të vendimit nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria koncesionare “W.E.T-T” sh.p.k., brenda 3 (tre) viteve, me fondet e veta, të pyllëzojë 4 (katër) ha me pyje në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor. Lloji i drurëve, që do të mbillen, dhe grafiku i mbjelljeve caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, e cila ndjek mbjelljet deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së pyllëzuar, sipas marrëveshjes që do të lidhë me kërkuesin.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

SIPËRFAQET QË HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR SIPAS PËRDORIMIT TË TERRITORIT DHE PRONËSISË

Nr.	**Ekonomia pyjore/kullosore**	**Ngastra**	**Sipërfaqja që hiqet, ha**	**Përdorimi i territorit**	**Forma e qeverisjes**	**Funksioni kryesor**	**Tipi i grumbullit**	**Pronësia**
1	EP Zalli Shkumbin	22/a	5.609	Tokë me bimësi pyjore	-	-	-	Shtetërore
2	EP Zalli Shkumbin	22/b	0.970	Tokë me bimësi pyjore	-	-	-	Shtetërore
3	EP Zalli Shkumbin	22/c	2.159	Tokë me bimësi pyjore	-		-	Shtetërore
	Totali		**8.738**					

PLANIMETRIA E NYJES HIDROENERGJEITKE HIDROCENRALI TOPCIAS
AZHORNIMI ME PRONESINE



SH. 1. 2000

W. E. T. sha

KONTRATE KONCESIONI
E FORMES ROTY NDERTIM, OPERIM, TRASFERIM
PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALIT "TOPCIAS"
Nr. 2393 Rep. Nr. 1219 Kol



KOORDINATAT E SHTESHIT TE MARRATENE TE NJESIS HIDROENERGJETIKE

pika 1	X=4422004.2484	Y=4550219.4338	
pika 2	X=4422074.8284	Y=4550660.5560	
pika 3	X=4422139.5784	Y=4550685.5481	
pika 4	X=4422139.5784	Y=4550727.6691	
pika 5	X=4422144.7124	Y=4550754.8534	
pika 6	X=4422096.3301	Y=4550983.0000	
pika 7	X=4422067.9188	Y=4550988.4701	
pika 8	X=4422053.3125	Y=4550987.8934	
pika 9	X=4422038.8567	Y=4550922.2705	
pika 10	X=4422067.3186	Y=4550924.3535	
pika 11	X=4421989.7161	Y=4550822.4993	

Nr. 2393 Rep. Nr. 1219 Kol

	MBI VOHET
	DATA
TOPCIAS I LUMASAN	GUSHT 2010

P-01

W. E. T. sha

Ing. Osmal Shazaj

5437

VENDIM
Nr.537, datë 27.7.2011

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE "LASHKIZË 1" DHE "LASHKIZË 2" DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, shkronja "b", e 23, pika 3 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncensionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion të hidrocentraleve "Lashkizë 1" dhe "Lashkizë 2", të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Dhënien e bonusit prej 2 (dy) pikëve për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) që i jepet shoqërisë "Hidrotimb" sh.p.k., për dhënien me koncesion të këtyre hidrocentraleve.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentraleve "Lashkizë 1" dhe "Lashkizë 2", të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.538, datë 27.7.2011

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË AUTORIZIMIN DHËNË "ENPOWER ALBANIA" SHPK PËR NDËRTIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK ME ERË (PARQE EOLIKE) TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.512, DATË 13.5.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 34/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në autorizimin dhënë "Enpower Albania" sh.p.k., filiali "Moncada Energy Group", Itali të miratuar me vendimin nr.512, datë 13.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik me erë (parqe eolike) për "Enpower Albania" sh.p.k., të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Republika e Shqipërisë
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

DISA NDRYSHIME NË AUTORIZIMIN NR.1, DATË 24.3.2009 "PËR NDËRTIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK ME ERË (PARQE EOLIKE) NGA SHOQËRIA ENPOWER ALBANIA SHPK

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 34/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1701, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni", me autorizimin nr.1, datë 24.3.2009 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës "Për ndërtimin e centralit elektrik me erë (parqe eolike) nga shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k., miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.512, datë 13.5.2009 të dhënë shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k., (filial në Shqipëri i "Moncada Energy Group" srl në Itali), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në adresën: Rr. "Ismail Qemali", Pallati Gener, kati 2, zyra 10, Tiranë, Shqipëri, regjistruar në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, mbajtëse e NUIS K72312008Q, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshon si vijon:

"Enpower Albania sh.p.k. autorizohet për ndërtimin e centralit elektrik me erë (parqe eolike) me karakteristikat e mëposhtme:

i) fuqi e instaluar deri në 501 MW;

ii) jo më shumë se 190 njësi gjeneruese (aerogjeneratorë) me kapacitet nga 2MW deri në 4,5MW secila;".

2. Pika 4 ndryshon si vijon:

"Afatet kohore të realizimit të projektit për ndërtimin e centralit elektrik me erë, lidhja me sistemin elektro-energjetik shqiptar dhe vënia në punë e parqeve eolike do të jenë ato të paraqitura në kronoprogramin e punimeve bashkëngjitur këtij autorizimi (data përfundimtare e vënies në punë të gjithë centralit nuk ndryshon dhe është 31.12.2014)".

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço

KRONOPROGRAMI I PUNIMEVE

CENTRALI EOLIK I VENDODHUR NE KARABURUN, MALET RREZA E KANALIT DHE MALET LUNGARE	MUAJ
	55
Miratimi i Autorizimit për Ndërtim (1° mile stone)	3
Sigurimi të drejtave të përdorimit të trojeve pronë shtetërore	3
Miratimi i Licencës së Prodhimit (ERE)	2
Sigurimi i të drejtave të përdorimit të sipërfaqeve pronë private	8
Përcaktimi i Kontratave Financiare	10
Përcaktimi i Kontratave të Furnizimeve	4
Inxhinierizimi dhe Projektimi Ekzekutiv Elektrik	5
Projektimi Ekzekutiv Civil	5
Miratimi i Lejeve të Sheshit dhe Lejeve të Ndërtimit	4
Fillimi i punimeve Loti i 1-rë (240 MW) (2° mile stone)	
Veprat Civile Loti i 1-rë	13
Pregatitje Loti i 1-rë	11
Montime Loti i 1-rë	13
Linja e Tensionit të Lartë dhe lidhja me N.St. HVDC në Vlorë	13
Kolaudime të Lotit të 1-rë	6
Aktivizimi i Lotit të 1-rë (3° mile stone)	
Vonesa të mundëshme në Lotin e 1-rë	7
Fillimi i punimeve për Lotin e mundshëm të 2-të	
Veprat Civile për Lotin e mundshëm të 2-të	10
Pregatitja për Lotin e mundshëm të 2-të	11
Montime të Lotit të e mundshëm të 2-të	
Kolaudimi i Lotit të e mundshëm të 2-të	6
Aktivizimi i Lotit të e mundshëm të 2-të (4° mile stone)	
Vonesa të mundshme në Lotin e 2-të të mundshëm	



VENDIM
Nr.539, datë 27.7.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.112, DATË 21.2.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, shkronjat "ç", "d" dhe "e", dhe 7, pika 1, të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar, të neneve 17 e 18 të ligjit nr.10 303, datë 15.7.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)" dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kudo në vendimin nr.112, datë 21.2.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, emërtimi "…Agjencia Shqiptare e Investimeve dhe Biznesit (ALBINVEST)…" të zëvendësohet me emërtimin "…Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)…"

2. Të drejtat dhe detyrimet që ushtronte Agjencia Shqiptare e Investimeve dhe Biznesit (ALBINVEST), të cilat megjithëse nuk përfshihen në ligjin nr.10 303, datë 15.7.2010, i kalojnë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.540, datë 27.7.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.489, DATË 25.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR FONDIN E GARANTIMIT TË KREDIVE TË EKSPORTIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 15 të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar, të nenit 38 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 17 e 18 të ligjit nr.10 303, datë 15.7.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kudo në vendimin nr.489, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave, emërtimi "…Agjencia Shqiptare e Investimeve dhe Biznesit (ALBINVEST)…" zëvendësohet me emërtimin "…Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)…:.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.542, datë 27.7.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LEJES PËR NDËRTIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E LINJËS TREGTARE, TË INTERKONJEKSIONIT ME RRYMË TË VAZHDUAR, NDËRMJET KALLMET/LEZHË (SHQIPËRI) DHE ZAPPONETA/MANFREDONIA (ITALI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e lejes nr.4/1, të datës 7.12.2009 "Për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar, ndërmjet Kallmet/Lezhë (Shqipëri) dhe Zapponeta/Manfredonia (Itali)", miratuar me vendimin nr.31, datë 20.1.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e lejes për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare të interkonjeksionit me rrymë të vazhduar, ndërmjet Kallmet/Lezhë (Shqipëri) dhe Zapponeta/Manfredonia (Itali)", bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i katërt ndryshohet, si më poshtë vijon:

"-Puna për ndërtimin e linjës duhet të fillojë brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtyre ndryshimeve të kësaj lejeje.".

2. Paragrafi i pestë ndryshohet, si më poshtë vijon:

"-Leja hyn në fuqi pas miratimit të këtyre ndryshimeve nga Këshilli i Ministrave.".

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.30, datë 4.8.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË "DISPOZITAT NORMATIVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Për akordimin e Medaljes së Artë:

I. Neni 39 "Medalja e Artë" i "Dispozitave normative për arsimin parauniversitar" ndryshon si më poshtë:

"Neni 39
Medalja e Artë

Nxënësit i akordohet "Medalje e Artë", kur ai plotëson një nga dy kriteret e mëposhtme:

1.

a) Të ketë notë mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme jo më pak se 9.80.

b) Në provimet e detyruara të Maturës Shtetërore të ketë mesataren e notave të shkallëzuara jo më pak se sa 9.80.

c) Në provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore të ketë mesataren e notave të shkallëzuara 10.00.

2.

a) Është fitues i një prej tri vendeve të para në olimpiadat ndërkombëtare me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse."

II. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri i Arsimit Parauniversitar, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit dhe DAR/Za-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.33, datë 5.8.2011

PËR PROCEDURËN E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PRIVAT, SI EDHE PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 33, pika 5, të nenit 34, pika 1 dhe të nenit 35 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Institucionet private të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë. Procesi monitorohet nga rektori i institucionit privat të arsimit të lartë (IAL private).

2. Institucionet private të arsimit të lartë shpallin hapjen e procedurës së pranimit të kërkesave të kandidatëve që dëshirojnë të vazhdojnë programet e studimit të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë dhe kriteret e pranimit të tyre.

3. Aplikimi për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet private të arsimit të lartë, të kryhen deri më datë 15 dhjetor 2011. Për aplikim, kandidati duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomën e Maturës Shtetërore, së bashku me certifikatën e notave ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të në Shqipëri. Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011, të dorëzojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme.

b) Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) 2 fotografi;

ç) Shtetasit e huaj duhet të paraqesin lejen e qëndrimit në Shqipëri (kopje e noteruar).

4. Në qoftë se kandidati nuk ka dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga drejtoria arsimore rajonale/zyra arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme lëshuar nga Arkivi Qendror i Shtetit.

5. IAL-të private i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), brenda datës 24 dhjetor 2011, një listë të studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe

në CD). AKP-ja, brenda datës 25 janar 2012, u dërgon IAL-ve private listën përkatëse me numrat e matrikullimit të studentëve.

6. Aplikimi për regjistrim në programet e studimit të ciklit të dytë, "Master i Shkencave" ose "Master i Arteve të Bukura" dhe "Master Profesional", në institucionet private të arsimit të lartë të kryhen deri në datën e përcaktuar nga IAL-të private. Për aplikim, kandidati duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kopje të noteruar të diplomës së lëshuar në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë të shoqëruar me listën origjinale të notave;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) 2 fotografi;

ç) Shtetasit e huaj duhet të paraqesin lejen e qëndrimit në Shqipëri (kopje e noteruar).

Studentët, të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në të njëjtën IAL private ku aplikojnë për t'u regjistruar në programet e studimit "Master i Shkencave" ose "Master i Arteve të Bukura" dhe "Master Profesional", nuk janë të detyruar të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm.

7. IAL-të private i dërgojnë AKP-së një listë të studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD). AKP-ja, brenda 3 javësh, u dërgon IAL-ve private listën përkatëse me numrat e matrikullimit të studentëve.

8. Pas procesit të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë, IAL-të private përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr.9, datë 25.2.2010 "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore".

9. IAL-të private regjistrojnë studentët në regjistrin bazë në përputhje me përcaktimet e udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit" dhe të urdhrit nr.150, datë 7.4.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për përcaktimin e kodit të regjistrave të studentëve në IAL".

10. Transferimi i studimeve nga institucionet publike të arsimit të lartë në institucionet private të arsimit të lartë dhe anasjellas të bëhet, sipas kritereve të përcaktuara në statutet e institucioneve dhe rregulloren e njësisë kryesore ku bëhet transferimi i studimeve.

11. IAL-të i dërgojnë një listë të studentëve të transferuar, në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD), AKP-së. AKP-ja bën përditësimin e të dhënave dhe transferimin e numrit individual të matrikullimit.

12. Ngarkohen Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria për Zhvillimin e Arsimit Jo-Publik, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si edhe institucionet private të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.319, datë 4.8.2011

PËR DELEGIMIN E AUTORITETIT, PËR MIRATIMIN E PAGESAVE TË SHTESËS PËR ORË PUNE MBI KOHËN NORMALE TË PUNËS, PËR PUNONJËSIT E POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 27-33 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", të ndryshuar, të pikës 2/c të nenit 7 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", si dhe të vendimit nr.463, datë 16.6.2011 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore"", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të autoritetit për miratimin e pagesave të shtesës për orë pune mbi kohën normale të punës, për punonjësit e Policisë së Shtetit.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

URDHËR
Nr.322, datë 9.8.2011

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të nenit 27 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", (të ndryshuar), si dhe të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave "Për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri",

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, të lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë Ministrinë.
2. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, sipas pikës 1 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga ligji nr.8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë" (të ndryshuar), në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.
3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr.1 të këtij urdhri.
4. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse deri në miratimin e këtij urdhri të ri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrave nr.642, datë 25.9.2009 dhe nr.50, datë 11.3.2011 "Për delegim kompetence", do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor.
5. Për autorizimet e lëshuara sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të gjejë zbatim ky i fundit.
6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike për zbatimin e këtij urdhri.
7. Çdo urdhër që bie ndesh me këtë urdhër shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

Lidhja nr.1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr._____Prot Tiranë, më_____2011

AUTORIZIM
PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN CIVILE ME PALË:

Paditës:
E paditur:
Objekti:

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile dhe të urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr._____datë_____"Për delegim kompetence",

VENDOSA:

Autorizimin e z/znj_____, me detyrë_____për të përfaqësuar Ministrinë e Brendshme në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes civile me objekt "_____" deri në shpalljen e vendimit në Gjykatën e_____

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Florjan Nuri

VENDIM
Nr.63, datë 27.7.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ERMA MP" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, germa "a", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa "a", të Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "ERMA MP" sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Erma MP" sh.p.k. plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Kërkesa që ka të bëjë me lejet nga institucionet e tjera (pika e lidhjes nga rrjeti i shpërndarjes; neni 9 pika 4.1.5), rezulton në proces realizimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për licencimin e shoqërisë "Erma MP" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec "Çarshovë".

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.64, datë 27.7.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "ERMA MP" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa "a", nenit 9 dhe 13, pika 1 germa "d", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1 germa "a", dhe 3, të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Erma MP" sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Erma MP" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencë të shoqërisë "Erma MP" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.65, datë 27.7.2011

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "FAVINA 1" SHPK ME SERI PV05P, NR.29, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.85, DATË 27.12.2005

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 13, 14 dhe 15 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "Favina 1" sh.p.k, për modifikimin e licencës nr.29, seria PV05P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Kërkesa e shoqërisë "Favina 1" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Informacioni me shkrim, ku shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikim licence (neni 15, pika 4 germa "a"), është dhënë në mënyrë të detajuar.
- Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës (neni 15, pika 4 germa "b"), është dhënë konform rregullores.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e licencës nr.29, seria PV05P, të shoqërisë "Favina 1" sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit prodhim i energjisë elektrike nga hec–"Vithkuq".

2. Fuqia e instaluar e hec–"Vithkuq" nga 2115 kW të bëhet 2715 kW.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.66, datë 27.7.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "IDRO ENERGJIA PULITA" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa "a", 9, 13 pika 1, germa "a" dhe 15 pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "a", 5 pika 1 germa "a", 12, 13, 14 pika 1 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Idro Energjia Pulita" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Idro Energjia Pulita" sh.p.k. plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me miratimin e pikës së lidhjes në rrjetin e shpërndarjes është në proces miratimi.(neni 9 pika 4.1.5).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Idro Energjia Pulita" sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et "Gostivisht" me fuqi 1.3 MW, "Langarica 3" me fuqi 2.2 MW dhe "Ura e Dashit" me fuqi 1.2 MW për një afat 30-vjeçar, me kusht që:

Shoqëria "Idro Energjia Pulita" sh.p.k. të dorëzojë "Miratimin e pikës së lidhjes me sistemin e shpërndarjes" brenda 90 ditëve nga data e miratimit të licencës.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.67, datë 27.7.2011

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "DOSKU-ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa "a", 9 dhe 13 pika 1, germa "a", neni 15 pika 3, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa "a", 5, pika 1 germa "a", 8 pika 4 dhe neni 13 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.7.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Dosku–Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Dosku Energy" sh.p.k. plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b","c", "d","f" dhe "g") janë plotësuar plotësisht me përjashtim të kërkesës së germës "e" për shkak të mungesës së certifikatës së regjistrimit të pronësisë së subjektit "Dosku-Energy" sh.p.k.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa "a", "b" dhe "d") janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë "Dosku-Energy" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali "Gizavesh", me kusht që subjekti "Dosku Energjy" sh.p.k. të paraqesë certifikatën e regjistrimit të pronësisë brenda 2 (dy) vjetësh nga data e dhënies së licencës.
2. Afati i kohëzgjatjes së licencës do të jetë 30 vjet.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.68, datë 9.8.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË "HP OSTROVICA ENERGY" SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (HEC FAQEKUQ 1 DHE HEC FAQEKUQ 2) SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa "ll", 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa "d", dhe 3 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21 datë 18.3.2009, dhe neneve 6, 7 dhe 8 të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 9.8.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Hp Ostrovica Energy" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues HEC "Faqekuq 1 dhe Faqekuq 2", si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "Hp Ostrovica Energy" sh.p.k. është konform rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1 , germa "a", "b", "c", "d"

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germa "a", "b", "c", "d"

Dokumentacioni vijues grafik, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Hp Ostrovica Energy" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues hec "Faqekuq 1 dhe Faqekuq 2", si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.69, datë 9.8.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "DITEKO" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET NË LUMIN "ZALLI I OKSHTUNIT": "BOROVË", "ZABZUN", "SEBISHT", "PRODAN 1", "PRODAN 2", "OKSHTUN EKOLOGJIK", "TERNOVË", "OKSHTUN", "LUBALESH 1", "LUBALESH 2" DHE "GJORICË"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa "a", nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa "a", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa "a", të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.8.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Diteko" sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Diteko" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për licencimin e shoqërisë "Diteko" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec-et në lumin "Zalli i Okshtunit": "Borovë", "Zabzun", "Sebisht", "Prodan 1", "Prodan 2", "Okshtun ekologjik", "Ternovë", "Okshtun", "Lubalesh 1", "Lubalesh 2" dhe "Gjoricë".
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.70, datë 9.8.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "DITEKO" SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa "a", nenit 9 dhe 13, pika 1 germa "d", të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa "g" dhe 10 pikat 1, dhe 3 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pika 1 germa "a", të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.8.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë "Diteko" sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Diteko" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencë të shoqërisë "Diteko" sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.71, datë 9.8.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË "DITEKO" SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR "HEC-ET NË LUMIN ZALLI I OKSHTUNIT": HEC-ET "BOROVË", "ZABZUN", "SEBISHT", "PRODAN 1", "PRODAN 2", "OKSHTUN EKOLOGJIK", "TERNOVË", "OKSHTUN", "LUBALESH 1", "LUBALESH 2" DHE "GJORICË" SI BURIM I RINOVUESHEM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa "ll", 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa "d", të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21 datë 18.3.2009, dhe neneve 6, 7 pikat 1 e 2 dhe nenit 8 të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 9.8.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Diteko" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec-et: "Borovë", "Zabzun", "Sebisht", "Prodan 1", "Prodan 2", "Okshtun Ekologjik", "Ternovë", "Okshtun", "Lubalesh 1", "Lubalesh 2" dhe "Gjoricë" si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "Diteko" sh.p.k. është konform rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germa "a", "b", "c", "d"

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germa "a", "b", "c", "d"

Dokumentacioni vijues grafik, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Diteko" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hec-et: "Borovë", "Zabzun", "Sebisht", "Prodan 1", "Prodan 2", "Okshtun ekologjik", "Ternovë", "Okshtun", "Lubalesh 1", "Lubalesh 2" dhe "Gjoricë" si burim i rinovueshem energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.72, datë 9.8.2011

PËR MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË ASETIT, PËRKATËSISHT NËNSTACIONIN 110/20KV TË "KALIMASHIT" NGA OST SHA TEK SHOQËRIA "CEZ SHPËRNDARJE" SHA

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika "1" të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10 pika 3 dhe nenit 11 të rregullores "Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikës 1.3 të licencës "Për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.8.2011, pasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve nga shoqëria OST sh.a. tek shoqëria "CEZ Shpërndarje" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "OST" sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit", si më poshtë:

- Neni 7, pika 1.1 dhe 1.2 emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte).
- Neni 7, pika 1.3, germa "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g", "h", përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetit e tij (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.).
- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është plotësuar tërësisht.).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e asetit, përkatësisht nënstacionin 110/20kv të "Kalimashit", nga "OST" sh.a. tek shoqëria "CEZ Shpërndarje" sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr.208, datë 25.7.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE "CITY RADIO ALBANIA" SUBJEKTIT: SHOQËRIA "CITY RADIO ALBANIA"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", miratuar me vendimin nr.355, datë 29.8.2005 të KKRT-së dhe rregullores "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "City Radio Albania" sh.p.k., për t'u licencuar si operator radiofonik privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë shoqërisë "City Radio Albania" sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik privat vendor, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë-Durrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.209, datë 25.7.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE "RADIO CLAZZ" SUBJEKTIT: SHOQËRIA "CLAZZ RADIO" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", miratuar me vendimin nr.355, datë 29.8.2005 të KKRT-së dhe rregullores "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "Radio Clazz" sh.p.k., për t'u licencuar si operator radiofonik privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. T'i japë shoqërisë "Clazz Radio" sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik privat vendor, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qarqet Tiranë-Durrës-Fier-Vlorë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.212, datë 25.7.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV ELRODI"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë 'Albania Byaty" sh.p.k. dhe propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të dokumentacionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat "Tv Elrodi", në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.7.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.213, datë 25.7.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV BLU SKY"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, person fizik z.Gëzim Brahusha, si dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor privat "Tv Bluy Sky", në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.7.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.214, datë 25.7.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK ME PËRSËRITËS "RFI"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Për licencimin e operatorëve për ritransmetimin e programeve të huaja dhe radio me përsëritësa", të miratuar me vendimin nr.26, datë 23.10.2000, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Ambasadës Franceze në Tiranë, si dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik me përsëritës "RFI", për ritransmetimin e programeve të huaja.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 12.4.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.215, datë 25.7.2011

PËR MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV DARDAN"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahimi	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti televiziv privat vendor "TV Dardan"

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21 dhe neni 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullorja "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

VËREN SE:

Në bazë të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe rregullores "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, shoqëria "Dardani" sh.p.k., ka paraqitur dokumentacionin për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor "TV Dardan",

KKRT konstaton se nga shqyrtimi tërësor i aplikimit për rinovimin e licencës së subjektit "TV Dardan", rezulton se:

Subjekti televiziv privat vendor "TV Dardan" gjatë veprimtarisë së tij ka funksionuar duke shkelur kushtet e licencës së miratuar. Subjekti nuk ka emetuar sinjal analog, por sinjal numerik (digjital) pa autorizimin e KKRT-së, ndërkohë që nuk ka njoftuar asnjëherë për ndryshime të skemës apo parametrave teknikë të transmetimit. Me shkresën nr.791 prot., datë 19.9.2008 të KKRT-së, subjektit televiziv privat vendor "TV Dardan" i është kërkuar mbyllja e menjëhershme e transmetimeve numerike të palicencuara, pasi subjekti po në kundërshtim me kushtet e licencës, kishte instaluar në pikën e tij të transmetimit një stacion që transmetonte në teknikën numerike. Me vendimin nr.752, datë 7.11.2008, të KKRT-së është vendosur rrëzimi i kërkesës së këtij subjekti, për transmetime numerike eksperimentale.

Subjekti televiziv privat vendor "TV Dardan" është autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor, në fushën e transmetimeve analogjike tokësore, në përputhje me kushtet e kriteret e parashikuara në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Pjesë përbërëse e vendimit të licencimit është edhe aneksi i licencës, ku janë parashikuar struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifa.

Përveç sa më sipër, subjekti nuk ka njoftuar për ndryshime të ndodhura në këtë shoqëri gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës. Nga ekstrakti historik i regjistrit tregtar të shoqërisë "Dardani" sh.p.k., rezulton se subjekti ka bërë ndryshime në strukturën e ortakëve, ndryshime për të cilat KKRT-ja, nuk është njoftuar.

Kështu, në datën 16.12.2009, është larguar ortaku Lorenc Kita dhe është shtuar ortaku Julian Pema, me 100% të aksioneve.

Në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar: "I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës … dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve…"

Mosnjoftimi i ndryshimeve të ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesën për licencë, sipas nenit 137/4 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative, e cila ndëshkohet me sanksion me gjobë nga 60.000 deri në 1.000.000 lekë.

Gjithashtu aplikimi i subjektit rezulton me mangësi në dokumentacion pasi nuk është dorëzuar deklarata noteriale që vërteton se pronari apo ortakët e subjektit nuk zotërojnë licencë të mëparshme për transmetime televizive analoge vendore dhe nuk kanë aksione në një shoqëri radiotelevizive kombëtare si dhe nuk identifikohet autori i projektit teknik.

Jemi të mendimit se edhe caktimi i një afati tjetër për plotësimin e mangësive të konstatuara në dokumentacion, nuk do ta sillnin subjektin tuaj në pozitë të rregullt ligjore, duke qenë se shkelja e kryer nga ana juaj, dalja në transmetim në një format të ndryshëm nga ai i miratuar, përbën shkelje të rëndë e të pariparueshme.

Në mbështetje të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, i ndryshuar, KKRT-ja vendos për rinovimin ose për shpalljen e kandidaturave të reja nëse operatori i licencuar nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e këtij ligji.

Për gjithë sa më sipër, KKRT-ja e gjen kërkesën e subjektit tuaj për rinovimin e licencës të pambështetur në ligj e në prova.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, si dhe nenit 140 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën nr.002/TVL të subjektit televiziv privat vendor “TV Dardan”.
2. Licenca nr.002/TVL bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti sipas pikës 1 të këtij vendimi të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.222, datë 25.7.2011

PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR RADION PRIVATE VENDORE “ALBANIA FM” SUBJEKTIT: SHOQËRIA “ALBANIA FM” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr.355, datë 29.8.2005 dhe rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Albania FM” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së licencimit dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Albania FM” sh.p.k., për radion private vendore “Radio Albania FM”, sipas licencës nr.058/FML, në rrethet Tiranë-Durrës.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë përbërëse e licencës përkatëse dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.223, datë 1.8.2011

PËR VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV DURRËSI"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahimi	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi çështjen e vlefshmërisë së licencës së subjektit televiziv privat vendor "TV Durrësi".

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 1 dhe 3, neni 34 pika 4 dhe neni 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë".

VËREN SE:

KKRT-ja me vendimin nr.484, datë 17.7.2006, ka licencuar shoqërinë "Tv Durrësi" sh.p.k., për televizionin privat vendor "Tv Durrësi", duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore për një periudhë prej 5 vjetësh, për të mbuluar me sinjal qytetet Tiranë dhe Durrës.

Vendimi i KKRT-së, për dhënie licence ka hyrë në fuqi në datën 28.7.2006 dhe në datën 28.7.2011 ka përfunduar afati i licencës së këtij subjekti. Nga verifikimi i bërë në zyrën e arkivës dhe protokollit rezulton se subjekti nuk ka depozituar aplikim për rinovimin e licencës.

Sipas nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, "…Kërkesa për rinovimin e licencës bëhet 90 ditë përpara afatit të përfundimit të saj…"

Ndërsa neni 33 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, parashikon se:

"Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. Mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar:…"

Sa më sipër, rezulton se subjekti nuk ka paraqitur kërkesë për rinovimin e licencës dhe nuk ka depozituar aplikimin përkatës për rinovimin e saj, megjithëse është detyrim ligjor që 90 ditë para përfundimit të licencës subjekti të dorëzojë kërkesën përkatëse.

Nga ana tjetër, me vendimin nr.189, datë 22.10.2010, KKRT-ja ka vendosur heqjen e licencës së subjektit televiziv privat vendor, pasi ky subjekt megjithëse është licencuar që në vitin 2006, nuk kishte dalë ende në transmetim.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, neni 34, pika 4, germa "a":

"Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur:…4. Nuk ka filluar transmetimin pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe:

a) 270 ditë në transmetimet e televizioneve vendore…".

Sipas pikës 2 të vendimit të sipërcituar, subjekti kishte të drejtën e paraqitjes së pretendimeve të tij brenda një afati prej 30 ditësh. Me shkresën nr.6/1 prot., datë 26.11.2010, subjekti ka paraqitur ankim administrativ kundër heqjes së licencës së "Tv Durrësi", duke theksuar se nga ana e këtij subjekti është transmetuar në mënyrë numerike, në funksion të formatit DVB-H. Subjekti pretendon se kur ka filluar transmetimet në teknologjinë numerike, mungonte kuadri ligjor dhe për përfundim kërkon revokimin e vendimit nr.189, datë 22.10.2010 të KKRT-së.

Konkretisht subjekti pretendon se:

"…Kanali i transmetimit për të cilin jemi licencuar (kanali 29, banda UHF) ka qenë përherë i zënë nga shërbimi RF për të gjithë periudhën nga fillimi i transmetimit disa vite më parë e deri më sot…Pavarësisht kufizimeve në licencën tonë për formatin e transmetimit, ambicia jonë për të gjetur rrugët e reja të biznesit në fushën mediatike, na detyroi të rrezikonim duke investuar në këtë teknologji…Mendoj se është vendim jo i drejtë, i cili bazohet në faktin e mostransmetimit në teknologjinë analoge, dhe nuk merr parasysh faktin që frekuenca e dhënë në përdorim në bazë të licencës, është shfrytëzuar maksimalisht…Me keqardhje një mosrespektim të kërkesave të nenit 137, paragrafi i dytë, të ligjit nr.8410, i cili përcakton se: "KKRT-ja përcakton shkeljet konkrete, të cilat ndëshkohen nga sanksionet e përcaktuara në këtë nen, duke zbatuar fillimisht si rregull sanksionin e paralajmërimit. "Fatkeqësisht, KKRT-ja është shmangur nga kjo kërkesë e ligjit, duke sanksionuar subjektin tonë drejtpërdrejt…"

Lidhur me pretendimet e mësipërme, KKRT-ja konstaton se janë të pambështetura. Kanali i transmetimit 29 UHF, ka qenë në dispozicion të këtij subjekti, sipas licencës së miratuar nga KKRT-ja për transmetime analoge tokësore. Subjekti televiziv privat vendor "Tv Durrësi" është autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor, në fushën e transmetimeve analogjike tokësore, në përputhje me kushtet e kriteret e parashikuara në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Nga ana tjetër, subjekti është pajisur me licencën përkatëse në të cilën janë parashikuar struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifa. Subjekti televiziv privat vendor "Tv Durrësi", në kundërshtim me ligjin dhe me licencën e miratuar nga KKRT-ja, nuk ka dalë në transmetim sipas kushteve të licencës, duke e shkelur atë. Me shkresën nr.874 prot., datë 23.8.2008 të KKRT-së, subjektit i është vënë në dukje se kanali 29 UHF, për të cilin subjekti është licencuar nuk bën pjesë në kanalet numerike të caktuara për Shqipërinë prej marrëveshjes së nënshkruar në Konferencën Rajonale të Radiokomunikacioneve "Për planifikimin e shërbimit të transmetimeve numerike në pjesë të rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz".

KKRT-ja nuk ka lëshuar asnjë autorizim apo leje për eksperimentimin e transmetimeve numerike për subjektin "Tv Durrësi".

Subjekti televiziv privat vendor "Tv Durrësi" gjatë veprimtarisë së tij ka funksionuar duke shkelur kushtet e licencës së miratuar. Subjekti ka emetuar sinjal numerik (digjital) pa autorizimin e KKRT-së, ndërkohë që nuk ka njoftuar asnjëherë për ndryshime të skemës apo parametrave teknikë të transmetimit, ndërkohë që është licencuar për transmetime televizive analogjike tokësore. Subjekti ka transmetuar 16 programe që hynin në paketën programore të Digitalb Mobile, në të cilat nuk është përdorur logoja e subjektit "Tv Durrësi".

Në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, "I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave…ose për mosplotësimin e kushteve të caktuara në licencë dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve…"

Nga ana tjetër, me miratimin e ligjit nr.9742, datë 28.5.2007 "Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë", i është hapur rruga transmetimeve numerike. Neni 3 i ligjit, parashikon se KKRT-ja jep licenca për ndërtim dhe shfrytëzim rrjetesh numerike tokësore të transmetimit, dhe sipas pikës 2 të këtij neni: "2. Rrjetet numerike tokësore shfrytëzojnë vetëm frekuencat e përcaktuara për përdorim numerik". Rezulton se subjekti televiziv privat vendor "Tv Durrësi" ka filluar transmetimet numerike pa u pajisur me licencën përkatëse, por duke shfrytëzuar një kanal transmetimi të miratuar për transmetime analoge.

Arsyetimi i subjektit se kanali 29, në të cilin subjekti është autorizuar të transmetojë ka qenë përherë i zënë nuk qëndron pasi nga ana e subjektit nuk është dorëzuar asnjëherë që nga momenti i licencimit ndonjë ankesë lidhur me shfrytëzimin e kanalit. Madje në të kundërt nga sa pretendohet, nga ana e subjektit është vepruar tej të drejtave që burojnë nga licenca e miratuar e transmetimit, duke përdorur një format transmetimi të ndryshëm nga ai për të cilin është licencuar.

KKRT-ja konstaton se përveç faktit që subjekti nuk ka paraqitur interes për rinovimin e licencës, nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e ligjit gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, neni 33 pika 1 dhe 3, neni 34 pika 4 dhe neni 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr.083/TVL të subjektit televiziv privat vendor "Tv Durrësi".

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 muaji në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurave Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	328 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 1.9.2011
Doli nga shtypi më 2.9.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 36 lekë